

V E N D I M
Nr.127, datë 15.3.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.415, DATË 1.7.1998, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT
“GRUAJA DHE FAMILJA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.415, datë 1.7.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titull dhe në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi emërtimi “Gruaja dhe familja” zëvendësohet me emërtimin “Për mundësi të barabarta”.

2. Në pikën 2 në shkronjat “a” dhe “c”, fjalët “gruan dhe familjen”, shkronjën “d”, fjalët “të drejtat e gruas dhe çështjet e familjes” zëvendësohen me fjalët “mundësi të barabarta”. Ndërsa në shkronjat “b”, “e” dhe “f”, fjalët “gruas dhe familjes” zëvendësohen me fjalët “mundësive të barabarta”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1 dhe 3.2. me këtë përmbajtje:

“3.1. Paga e kryetarit të Komitetit “Për mundësi të barabarta” të jetë sipas klasës B/1, në lidhjen 1 “Renditja e funksioneve sipas klaisifikimit”, mbështetur në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndërsa paga e punonjësve të këtij Komiteti të jetë sipas lidhjes II/5, “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore.”.

“3.2. Për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, për mundësi të barabarta gjinore, krijohet Këshilli Qendror, me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale kryetar
- Ministri i Drejtësisë anëtar
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës anëtar
- Ministri i Shëndetësisë anëtar
- Zëvendësministri i Financave anëtar
- Zëvendësministri i Rendit Publik anëtar
- Kryetari i komitetit “Për mundësi të barabarta” anëtar
- dy përfaqësues të grupimeve më të mëdha të OJQ-ve, nga rradhët e grave anëtar

Për punën e kryer anëtarët e këtij këshilli shpërblehen sipas vendimit nr.720, datë 29.11.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë, që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore.”.

4. Pikat 4 dhe 5 të vendimit shfuqizohen.

5. Pika 6 ndryshon si vijon:

“Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Këshilli dhe Komiteti “Për mundësi të barabarta” për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta